

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Haga e bëri fajtor, Hashim Thaçi i drejtohet popullit dhe sfidon Gjykatën: Të bëhen publike provat për vra sjen e Heroit të Kosovës, Behajdin Allaqi
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/haga-e-beri-fajtor-hashim-thaci-i-drejtohet-popullit-dhe-kerkon-te-behen-p-i401489
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:45:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c87c1f6c2bf01d6ae247bdb46866d00f110dfbdae4c86230de44f4c8ae50d12f
TEKSTI	d6b9e64f2edb9e75fda9602510ac1889706abcfc4ed062b1af4a9b08ff5b0ce5
PAMJA	1dbff44a59ce594425a95d7435e7d0eb12a1aca0dde3c78cc6af5cd377b02b6d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	143615fb25fdf4f3bcf6ae4bf1716b4e38b8fddf2cc3b666167069850190d275
E MËPARSHMJA	1e63de51dab63c2f09736411c8d997f935f9d5b02ae5f5b612c4f63e9059050c
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/143615fb25fdf4f3bcf6ae4bf1716b4e38b8fddf2cc3b666167069850190d275>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

17 Shtator 2026, 21:39

Haga e bëri fajtor, Hashim Thaçi i drejtohet popullit dhe sfidon Gjykatën: Të bëhen publike provat për vrasjen e Heroit të Kosovës, Behajdin Allaqi



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Behajdin Allaqi dhe Hashim Thaçi

Ish-presidenti i Kosovës dhe një nga katër ish-drejtesit e lartë të Ushtrisë Çlirimtare që mbahen në qelitë e Hagës, Hashim Thaçi i është drejtuar publikisht popullit të tij përmes avokatit dhe kërkon nga qytetarët që të ruajnë qetësinë, pas padrejtësisë së djeshme.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi u shpallën fajtorë për disa akuzat nga Dhomat e Specializuara dhe janë dënuar me në total 81 vite burg. Një vendim i turpshëm, pasi akuzat kryesore për krime kundër njerëzimit ranë.

Një ndër akuzat themelore, por e kundërshtuar fort nga avokati dhe vetë Hashim Thaçi, është ajo për vrasjen e veprimtarit, intelektualit dhe luftëtarit Behajdin Allaqi. Ai është shpallur edhe Hero i Kosovës, ndërsa fati i tij nuk dihet.

Avokati thotë se Paneli i Gjyimit e ka shpallur publikisht zotën Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat u bazua ky përfundim i ka mbajtur të fshehura nga shqyrtimi publik. Gjithashtu, Paneli i Gjyimit më parë kishte urdhëruar të gjitha palët në

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

"I dërgova Trumpit letër dhe ai e lexoi", Berisha zbulon emrin e kompanisë së lobimit për heqjen e "Non Grata"-s: Ja sa kam paguar



Aktualitet

"Situatë jashtëzakonisht e rëndë për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit", Ish-ambasadori Bimo për vendimin e Gjykatës Speciale: Vendim i politizuar, shajptarët u kthyen në plaçkë tregu

Zbulohet më shumë artikuj >

çështje që të mos diskutojnë për rastin e z. Allaqi në seance publike dhe pasi kishte urdhëruar që të gjitha provat lidhur me atë rast të mbaheshin konfidenciale.

Në këto kushte, gjendur përballë kësaj akuze të rëndë, Hashim Thaçi ka kërkuar nga qelitë e Hagës që provat të bëhen publike dhe populli i Kosovës të njihet me to, duke sfiduar drejtpërdrejt Gjykatën e Hagës, pasi ai pretendon se nuk ka asnjë lidhje me vrasjen e Behajdin Allaqi.

"Për më tepër, dje Paneli i Gjykimit pretendoi publikisht se z. Thaçi ishte i përfshirë në vrasjen e Behajdin Allaqi, pasi më parë kishte urdhëruar të gjitha palët në çështje që të mos diskutojnë për rastin e z. Allaqi në seance publike dhe pasi kishte urdhëruar që të gjitha provat lidhur me atë rast të mbaheshin konfidenciale.

Kështu, Paneli i Gjykimit e ka shpallur publikisht z. Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat u bazua ky përfundim i ka mbajtur të fshehura nga shqyrtimi publik. Z. Thaçi do ta mirëpriste një shqyrtim të tillë publik të provave.

Mbrojtja do t'i apelojë vendimet e Panelit të Gjykimit për shkak të shkeljes së të drejtave të tij themelore për një gjykim të drejtë, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutës së Kosovës. Z. Thaçi mohon kategorikisht çdo përfshirje në vrasje.

Respektimi i standardeve rigoroze të drejtësisë procedurale është thelbësor për ruajtjen e besimit të publikut te institucionet ndërkombëtare penale. Mbrojtja do të dorëzojë zyrtarisht Njoftimin e Apelit para Panelit të Apelit, me qëllim korrigjimin e këtyre gabimeve faktike, ligjore dhe procedurale", ka shkruar Luka Mishetiç, avokati kryesor i ish-presidentit Hashim Thaçi.

Kush ishte Behajdin Allaqi?

Behajdin Allaqi, i lindur më 7 prill 1963 në Prizren, ishte veprimtar politik dhe pjesë e organizimeve politike shqiptare që prej viteve '80. Ai mori pjesë në demonstratat e vitit 1981 dhe më pas në veprimtarinë ilegale që synonte avancimin e statusit politik të Kosovës. Gjatë viteve '90 vazhdoi aktivitetin në strukturat e lëvizjes kombëtare dhe më vonë iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Allaqi u zhduk më 11 qershor 1998. Trupi i tij nuk është gjetur. Për më shumë se 28 vjet, familjarët, bashkëveprimtarët dhe figura të ndryshme publike kërkuar sqarimin e rrethanave të arrestimit, zhdukjes dhe vrasjes së tij. Përgjatë kësaj kohe qarkulluan akuza dhe dëshmi të ndryshme, por mungonte një konstatim gjyqësor që përcaktonte përgjegjësi individuale. Aktgjykimi i 16 shtatorit ndryshon pikërisht këtë pjesë të historisë së çështjes.

87. Gjithashtu, z. Thaçi mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme që përshinin si vijon. Përmes publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike dhe përdorimit të "luftës speciale", z. Thaçi shprehu tolerancë dhe inkurajim për kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve. Z. Thaçi gjithashtu mori pjesë personalisht në krime, përfshirë në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve në Qirez dhe Baicë, në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqi, dhe kishte dijeni për arrestimin dhe ndalimin e disa personave të tjerë. Në lidhje me Behajdin Allaqin, Trupi Gjyqësor konstatoi se në vitin 1993, Behajdin Allaqi kishte pasur një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën, të cilët e akuzuan se kishte sjellë një spiun të pretenduar të Serbisë, Shaban Shalën, në radhët e lëvizjes politike të cilës i takonin, me çka i kishte vënë në rrezik të madh anëtarët e lëvizjes. Kjo rezultoi në marrjen prej z. Thaçi të rolit që i ishte premtuar Behajdin Allaqi. Trupi Gjyqësor gjithashtu ka konstatuar se para zhdukjes së tij, Behajdin Allaqi kishte qenë nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Më 11 qershor 1998, ose rreth kësaj date, Behajdin Allaqi u nis prej shtëpisë së vet dhe shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Pak më pas, mbërritën z. Thaçi dhe Kadri Veseli. Ata e morën Behajdin Allaqin në pranga. Behajdin Allaqi nuk u pa më kurrë dhe Trupi Gjyqësor është bindur se ai u vra. Për të fshehur përgjegjësinë, personat në fjalë ndërmorën masa të ndryshme. Më 1 nëntor 1998, u publikua Komunikata 61 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ku thuhet se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Kjo ishte mbulesë që kishte për

qëllim të fshihte të vërtetën për atë që i kishte ndodhur Behajdin Allaqit. Po kështu, pas luftës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Azem Syla u përpoqën të qetësonin familjen e Behajdin Allaqit me ryshfet dhe premtime në mënyrë që të hiqte dorë nga kërkimi i drejtësisë dhe i së vërtetës. Është meritë e jashtëzakonshme e familjes që u rezistoi këtyre ofertave. Edhe Shaban Shala ishte

Pjese nga dosja e Dhomave te Specializuara te Hages

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Enjte 22:13

81 vite për Çlirimtarët, ish-emisari amerikan: Kosova nuk ka nevojë për një gjykatë në Holandë që të marrë vendime, sepse dënimi ishte i ndikuar politikisht



Rajoni

U dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara, reagon për herë të parë Hashim Thaçi! Thirrje qytetarëve të Kosovës: Ruani qetësinë

E Enjte 18:53




Rajoni

Dimri po afron, Mitsotakis njofton ndërhyrjen në tregun e hidrokarbureve: Nafta do të shitet 1.75 euro/litri për...

E Enjte 18:26





E Enjte 17:45

Pasi Haga dha 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, Kurti pret Hamzan, diskutohet APELIMI i aktgjykimit



Rajoni

FOTO-LAJM/ Vendimi i Hagës nuk e lë pa shpresë familjen e Rexhep Selimit, bashkëshortja e tij krahë fëmijëve: Gjithmonë krenarë e të fortë

E Enjte 15:46



Rajoni

"O Hashim ti ku je? Krejt Kosovën këtu e ke!" Studentët nuk heqin dorë, mbushin dhe sot Prishtinën, "në këmbë" për çlirimtarët (PAMJE-DETAJE)

E Enjte 13:07 Newsbomb



E Enjte 12:15

Ministri i Arsimit italian merr zarf kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Akte frikacake nuk kanë vend në një demokraci



Rajoni

E TURPSHME/ "Kalbu në burg o i mjerë", politikani malazez nuk përmbahet ndaj Hashim Thaçit pas vendimit të Hagës

E Enjte 10:38



Rajoni

"Prita 6 vjet që babai im të vinte, por ma kthyen me eshtrat e copëtuaara", rrëfimi RRËQETHËS i Arben Zeqirit për ditën kur serbët vranë 72 shqiptarë në Vushtrri

E Enjte 10:11





🕒 E Mërkurë 21:36

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.